



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**U R D H Ë R
Nr. 288 Datë 21. 10. 2004**

PËR

**PËRGATITJEN E TEMAVE LIDHUR ME NDRYSHIMET E REJA LIGJORE NË
FUSHËN PENALE**

Me synim,

- njohjen, kuptimin, interpretimin dhe zbatimimin e drejtë të ndryshimeve të reja në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, si dhe;
- ngritjen e grupeve të punës për përgatitjen e disa temave lidhur me ndryshimet e reja ligjore në fushën penale;

Mbështetur, në nenin 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organi[^]imin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë";

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupeve të punës për përgatitjen e temave që do të punohen dhe diskutohen në seminar me prokurorë të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, për njohjen, kuptimin, interpretimin dhe zbatimimin e drejtë të ndryshimeve të reja në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

2. Temat e seminarit dhe anëtarët e grupeve të punës që do merren me përgatitjen dhe punimin e tyre në seminare janë, si më poshtë:

2.1. Format e veçanta të bashkëpunimit. Organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, dallimi i këtij të fundit me bashkëpunimin e thjeshtë, (neni 28 i KP).

Zamir Shtylla, Arqile Koça, Artur Selmani

2.2. Korrupsioni aktiv dhe pasiv në sektorin privat, (nenet 164/a dhe 164/b të KP). Korrupsioni aktiv dhe pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, (nenet 244 e 259 të KP), i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendore (nenet 245 e 260 të KP), dhe i gjyqtarit, prokurorit ose funksionarëve të organeve të drejtësisë (nenet 319 e 319/a të KP). Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës, (neni 170/b i KP). Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, (neni 245/1 i KP).
Saliko Hajno, Arben Kraja, Ardian Visha.

23. Shpërdorimi i detyrës (neni 248 i KP). Të rehat që sjellin ndryshimet në Kodin Penal. Dallimet midis përgjegjësive penale dhe përgjegjësive administrative e financiare të funksionarëve publikë. *Bilbil Mete, Aleksandër Goga, Ylli Basha.*

2.4. Mbrojtja e dëshmitarit dhe bashkëpunëtorit të drejtësisë, kushtet dhe garancitë e pyetjes së tyre, (ligji nr. 9205 datë 15. 03. 2004 "Për mbrojtjen e dëshmitare dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë" dhe nenet 37/a, 361/a të KPP). *Kujtim Luli, Alfred Progonati, Koli Bele.*

2.5. Përgjimi në vende publike, veprimet simuluese dhe infiltrimi i punonjësve të policisë (nenet 222/1 paragrafi dytë dhe tretë, 294/a dhe 294/b të KPP). *Kasëm Berberi, Artan Lulaj, Pertef Hamzaj.*

3 Grupet e punës, të përfundojnë përgatitjen e temave brenda datës 15 nëndor 2004 dhe të depozitojnë një kopje të tyre në Drejtorinë e Studimeve.

4 Seminaret do të zhvillohen në datat, si më poshte:

4.1. Në datë 18. 11. 2004, ora 09. 00, do të punohen temat e përcaktuara në pikat 2.1 dhe 2.3 më sipër;

4.2. Në datë 22. 11. 2004, ora 09. 00, do të punohet tema e përcaktuar në pikën 2.2 më sipër;

4.3. Në tretë, datë 25. 11. 2004, ora 09. 00, do të punohen temat e përcaktuara në pikat 2.4 dhe 2.5 më sipër;

5. Prokurorët e kësaj Zyre duhet të përgatiten për të marrë pjesë aktive në diskutimin e temave në seminare.

6. Drejtoria e Studimeve të ndjek përgatitjen në afat të temave nga grupet e punës. Administrata e kësaj Zyre, të marrë masat e duhura organizative dhe administrative për zhvillimin e këtyre seminareve. Temat e përgatitura të fotokopjohen dhe ti shpërndahen prokurorëve të kësaj Zyre, jo më vonë se dy ditë para ditës së seminarit.

7. Me këtë urdhër të njihen grupet e punës, prokurorët e tjerë dhe Sekretari i Përgjithshëm i kësaj Zyre.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM
THEODHORI SOLLAKU